

Thyamis



ALB

"...në aspektin gjuhësor, shumë studime dhe gjuhëtarë, duke përfshirë edhe Eqerem Çabej, prejardhjen e emrit Çamëri, e lidhin ngushtë me emrin e lumit Thyamis që njihet si territor shqiptar, gjë që provon autoktoninë e kësaj krahine."

Nr. 8 • Prill 2014

www.cameriainstitute.org

Buletin i Institutit të Studimeve për Çamërinë

INSTITUTI I STUDIMEVE PËR ÇAMËRINË
INSTITUTE OF CHAM STUDIES



Shpronësimet pas pushtimit të çamërisë nga qeveria greke (1912-1913)



Disa nga zërat më të fuqishëm të diplomacisë shqiptare në mbrojtje ...



Beqir Meta: "Për çështjen çame ..."



Kulla e Sulit

Këtë buletin kemi vendosur ta emërtojmë “Thyamis” për shkak të lidhjes së ngushtë të emrit Çamëri me emrin e lumit që e përshkon atë, *Thyamis*-in antik. Për prejardhjen e emrit Çamëri, trajtesat më të hershme u takojnë studiuesve të huaj, si W.M.Leake, Pouqueville, etj, të cilët janë përqendruar tek toponimia. Gjuhëtari shqiptar Eqerem Çabej, mbështet të njëjtën tezë duke vërejtur vazhdimësinë e dy termave nga *Thyamis* në *çam*, që shpjegohet nëpërmjet ligjësive fonetike të shqipes: Pjesa e parë (- *thy*) e kompozitës (-*thyamis*), rrjedh nga folja shqipe -*thyej*, ndërsa pjesa e dytë (-*am*), nga emri shqip ilirisht -*amë*, *ama*, *ëma*, në kuptimin *amtar*, e cila si formë fjalëformuese (*thy+am=thyam*), shkon në përfundim logjik të shprehjes shqipe *ama e thyer*, me kuptimin e *thyerjes së amës pellazgjike illire*. Mendohet se etimologjia shqipe e emrit të hidronomit *Thyamis*, linguistikisht, lidhet me formën tjetër të shqipes, ku nga “*thy amë*”, u krijua forma sinonimike *ça amë* që i përgjigjet folja shqipe *çaj* (*çarja e amës-ëmës*). Në këtë mënyrë, sipas mbështetësve të kësaj teze, është krijuar forma shqipe -*ça am(ë)*, (*u*) *ça ama*, ku me rënien e njëres zanore -*a*, formohet emërtimi *çamë* (*ça+amë*). Në trajtën e pashquar, emrit i shtohet prapashtesa -*ri*, duke formuar toponimin *Çamëri* (*ça+amë+ri*).

Stafi i buletinit:

Drejtoi :

Kaltra Bardhi dhe Ines Dako

Redaktoi në shqip :

Kaltra Bardhi

Grafika :

Alfred Nikolla, Endi Koçi

Një falenderim të veçantë për :

Hajredin Isufi

Beqir Meta

Botues :

Instituti i Studimeve për Çamërinë (ISÇ)

Drejtore të Institutit të Studimeve për Çamërinë:

Gjergj Xhafa

Instituti i Studimeve për Çamërinë (ISÇ) është një organ jo-fitimprurës. U themelua në maj të vitit 2004 në Tiranë, me iniciativën e një grupi prej 17 intelektualësh të fushave të ndryshme, si të shkencave politike, juridike, historike, sociologjike, të marrëdhënieve ndërkombëtare etj. ISÇ është regjistruar dhe funksionon në bazë të statutit dhe rregullores së vet, në harmoni me ligjet e shtetit shqiptar dhe të drejtës ndërkombëtare.

Qëllimi i këtij newsletter-i është të bëjë të mundur shpalosjen në masë të gjerë të historisë së Çamërisë, etnografisë, etnolinguistikës, dokeve, zakoneve dhe kulturës së bukur të krahinës së Çamërisë. Nëse i gjithë komuniteti çam kërkon një zgjidhje të kënaqshme, hapi i parë është sigurisht kthimi pas në të kaluarën, për të kujtuar gjithmonë historinë dhe arsyen që kërkojmë drejtësi. Synimi i newsletter-it tonë është të tregojë vlerat që populli çam ka patur dhe vazhdon të ketë, për t'i trashëguar ato edhe tek brezat e rinj, nëpërmjet kulturës dhe dialektit që e karakterizon.

Për këtë arsye, Instituti i Studimeve për Çamërinë me botimin e këtij newsletter-i ka për synim që nëpërmjet aktiviteteve të shumëllojshme dhe me tematikat e ndryshme që trajton, të ndërgjegjësojë masën për vlerat e këtij komuniteti.

Historiku

Shpronësimet pas pushtimit të çamërisë nga qeveria greke (1912-1913)

fq 3 - 4

Qytete

Këto troje na përkasin!

Suli

fq 5

Analizë kulturore

Hajredin Isufi: Disa nga zërat më të fuqishëm të diplomacisë shqiptare në mbrojtje të çështjes çame, 1913-1938

fq 6 - 7

Personalitete

Musa Demi

fq 8 - 9

Intervistë

Beqir Meta: “Për çështjen çame duhen kërkuar zgjidhje që i përshtaten kohës”

fq 10 - 13

Poezi

Namik Selmani

fq 14 - 15

SHPRONËSIMET PAS PUSHTIMIT TË ÇAMËRISË NGA QEVERIA GREKE (1912-1913)

Pas përfundimit të Luftës së Parë Ballkanike dhe veçanërisht pas botimit zyrtar të ligjit agrar në Greqi, qeveria greke zaptoi qetësisht, pothuajse të gjitha pasuritë rurale të shqiptarëve të Çamërisë, në mbështetje të dispozitave të Traktatit të Athinës së vitit 1913, ku çdo nënshetës grek që kishte tapitë e pronësisë, nuk i prekeshin pronat.

Qeveria greke nuk i respektoi këto angazhime që kishte nënshkruar në traktat, por nisi të përdorë lloj-lloj formash të drejtpërdrejta dhe të tërthorta për t'iu grabitur pronat shqiptarëve. Sapo një pronar paraqitej para gjykatës me dokumentat e veta të pronësisë, gjykata i lëshonte një vendim, duke i siguruar në këtë mënyrë pronën që ua kishin grabitur të krishterët. Ndërsa nga ana tjetër, e detyronte palën kundërshtuese të ngrinte një gjyq kundër pronarit të vërtetë. Kjo procedurë nuk ka qenë kurrë e aplikuar në favor të pronarit shqiptar.

Në këtë mënyrë, shqiptari çam, edhe pse ishte nën-

shtetas grek, ishte i zhveshur nga pronësia e tij. Pas Traktatit të Lozanës, mijëra refugjatë grekë, të ardhur nga Azia e Vogël, u vendosën në shtëpitë dhe tokat e çamëve myslimanë.



Katër-pesë familje çame mbledheshin në një shtëpi të madhe sepse shtëpitë

u ziheshin me forcë nga refugjatët grekë. Ata bëheshin jo vetëm zotër të shtëpive, por edhe të tokave, prodhimeve bujqësore, kullotave, plantacioneve me ullinj etj. Shqiptari fshatar çam nuk mund të bënte asnjë veprim reagues kur i grabiteshin prodhimet bujqësore sepse refugjatët grekë kishin mbrojtjen e xhandarmërisë dhe administratës lokale greke. Me ligjet e reformës

agrarë që u aplikuan shumë të ashpra vetëm në pronat e shqiptarëve të Çamërisë, shqiptari çam e ndiente veten të

shpronësuar, jo vetëm nga tokat që prodhonte dhe prodhimet bujqësore me të cilat mbante familjen, por deri edhe tek kopshet.

Në këtë situatë të rëndë, kur familjet shqiptare çame kërcënoheshin nga uria dhe mjerimi, nga fshatrat dhe qytetet e Çamërisë, nisën shumë ankesa në drejtim të qeverisë greke, duke iu drejtuar qeverisë shqiptare dhe Lidhjes së Kombeve që të ndërhyjnë pranë qeverisë së Athinës për të kërkuar kthimin e pronave të grabitura dhe shtëpitë ku ishin vendosur refugjatët çamë.

Në vargun e gjatë të letrave, memorandumëve, peticioneve, lutjeve që niste paria myslimane e Çamërisë nga Margëlliçi, Paramithia, Filati, Gumenica, ia vlen të përmendim dy prej tyre.

Së pari, Safet Dino,



pronar i madh në Paramithi. Më 10 dhjetor 1923, ai i drejtoi një lutje

Venixellos, kryetarit të qeverisë greke në Athinë, ku ndër të tjera i shkruante: "Masat që kishte ndërmarrë qeveria

greke me politikën e shpronësi-meve të pronarëve çamë, ishte një politikë jolargpamëse dhe do të bënte që të krijohej një hidhërim dhe antipati kundër Gre-qisë nën ndërgjegjen e atyre shqiptarëve të ndritur..”

Së dyti, Sabri Dino, një tjetër pronar i madh nga Paramithia. Ai, nën presionet e qeverisë greke ishte shpërngulur nga Paramithia në Lushnjë. Më 7 janar të vitit 1924, ai i dërgoi një letër kryeministrit të Shqipërisë në Tiranë, në të cilën i lutej qeverisë shqiptare që të ndërhynte pranë qeverisë greke që t'i riktheheshin pronat e grabitura.

Ai rendit një listë të gjatë të pronave (çifligjeve), të zaptuara nga qeveria greke që në vitin 1912, siç ishin çifligjet e tij në Filat, Margëlliç dhe Paramithi. Ai kërkonte nga qeveria shqiptare ndihmë për të ndërhyrë që t'i ktheheshin qoftë edhe një pjesë e pronave për të përballuar nevojat e jetesës dhe fëmijët e tij të mos vdisnin nga uria.

Për grabitjet e pronave të shqiptarëve të Çamërisë nga qeveria greke, reagoi ashpër edhe shtypi shqiptar.

Gazeta “Demokratia”, që dilte në Gjirokastrë, më 18 nëntor të vitit 1930, në editoria-lin e saj, botonte një shkrim të titulluar “Hajdutëri shtetërore”, ku ndër të tjera cilëso n t e : “Greqia, nuk është sprapsur

përpara asgjëje, as përpara krimit, që të realizojë programin e shfarosjes së vëllezërve tanë përtej kufirit, të cilët nderin pasurinë, jetën e rëndë nën thundrën e nënpunësit grek...

Në këto sjellje çnjërzore kriminale është edhe çështja e

pasurisë së shqiptarëve të Çamërisë. R e f o r m ë n agrare po e z b a t o j m ë , mirëpo duhet t'u jepet ç a m ë v e shpërblim, qoftë edhe qesharak. Por si të mos mjaftonte kjo, është grabitur pasuria e tyre, pa dhënë asnjë dhjetëshe...”

Duhet thënë se kjo situatë e tensionuar vijoi edhe në vitet në vijim. Në gazetën “Tomorri”, në shkrimin e datës 11

shtator të vitit 1940, është theksuar: “Një nga format më të rënda të ndjekjes së shqiptarëve në tokën greke është

ajo që g o d e t pronat e patund-s h m e , pikërisht s e p s e është e zhveshur f a r ë nga një legaliteti dhe nga një përgjithësi parimesh, ndërsa praktikisht është drejtuar vetëm kundër çamëve të mjerë dhe e frymëzuar me shpronësimin e të gjitha pronave të shqiptarëve në Greqi...”

Artikulli në fjalë, në mbyllje të tij, ka këtë paragraf: “Me të gjitha mjeshtëritë më të rafinuara, qeveria greke është përpjekur të rrëmbejë të drejtën e shqiptarëve mbi ato toka që atyre u përkisnin nga një pronë e sigurtë, qysh prej kohëve më të lashta, kur raca shqiptare shtrihej mbi gjithë atë krahinë, por as zhvillimi i kohës, as luftërat, revolucionet invadimet e pushtimet e huaja, që ndihnin njëra-tjetrën, nuk mund të bënin të harroheshin të drejtat primitive.”



SULI

Suli është një qytezë e vogël në krahinën e Çamërisë në Shqipëri. Ndodhet 45 km në jugperëndim të Janinës, në një vend malor dhe të fortifikuar nga natyra. Banorët, shqiptarë të krishterë, së bashku me popullsinë e fshatrave përreth, ruajtën të drejtën e mbajtjes së armëve, duke marrë përsipër në rast lufte, detyrën për të luftuar në radhët e ushtrisë osmane. Në vitin 1790, Ali Pashë



Tepelena, me qëllim që të shpërngulte suliotët nga vendi, dërgoi forca ushtarake kundra tyre, por pësoi humbje. Edhe në vitin 1792 suliotët qëndruan burrërisht, por sulmeve të viteve 1800 dhe 1803, popullsia e Sulit nuk mundi t'u bëjë ballë, duke parë si rrugëdalje të vetme shpërnguljen në Pargë, e cila në atë periudhë ishte nën sundimin e Anglisë. Qysh prej asaj kohe Suli u shkretua. Në revolucionin e fundit grek, si kryetarë më trima janë shquar

suliotët. Krahas trimërisë së dëshmuar gjatë viteve luftë të burrave çamë, një karakteristikë dalluese që

ka lënë shteg për studim, ka qenë edhe trimëria dhe bukuria e grave suliothe. Këto tipare të gruas çame, ndoshta do të krijonin një përfytyrim të saktë të hijeshisë së gruas shqiptare, që për Dora D'Istrian, “janë gratë më të bukura të

G a d i s h u l l i t Lindor... Mahnitesh me luginat e këndshme të Çamërisë, me bukuritë e virgjëreshave të saj me sy të zinj, flokët e mrekullueshme të të cilave, me ngjyrë të rreshkët në gështenjë, u rrëzohen gjer te them

bra...” (Dora D'Istria) Krahas bukurisë, si dhuratë e natyrës, trimëria e gruas çame ka qenë dhe ka zënë vend në kufijtë e legjendës. Rrëfimet e transmetuara brezave, gojëdhënat, këngët, por edhe dokumentet arkivore të kohës, e evidentojnë dendur këtë fakt. Faktet që e dëshmojnë këtë lidhen me betejat e ashpra të vitit 1792, kur Suli u sulmua nga forca t e


shumta të Ali Pashës, ku gratë suljote, për të cilat nderi ishte më i rëndësishëm se vetë jeta, rrëmbyen armët, duke sakrifikuar jetën. Tashmë, është i njohur akti heroik i dramës së grave suliothe në Zallong. Më shumë se 100 gra, duke shtrënguar në gji fëmijët e tyre, të ndjekura nga vajzat e tyre, u hodhën në humnerën e thepisur të shkëmbinjve të Zallongut. Ato morën një vendim të shpejtë për t'u



mbrojtur nga poshtërimi, turpi dhe tortura. U kapën dorë për dorë dhe mbi sheshin e shkëmbit hodhën “vallen e vdekjes”.

NGA HAJREDIN ISUFI

DISA NGA ZËRAT MË TË FUQISHËM TE DIPLOMACISË SHQIPTARE NË MBROJTJE TË ÇËSHTJES ÇAME, 1913-1938




Forcat greke e pushtuan Çamërinë në shkurt të vitit 1913. Marrja e Çamërisë pasoi me një valë krimesh dhe terrori mbi popullsinë, veçanërisht mbi atë myslimane. Gjatë kësaj kohe, qeveria greke akuzohej për hapjen e burgjeve të Janinës për kriminelët e dënuar kretas, për pajisjen e tyre me armë dhe ndërmarrjen e sulmeve të shqiptarve të Çamërisë e të viseve të Shqipërisë së Jugut. Banda kreteze masakroi barbarisht 72 çamë nga paria e Çamërisë, dogji dhe shkretoi shumë fshatra çamë: si Gardhiqi, Dhragomia, Karbunari, etj. Qeveria greke mbushi burgjet e Janinës me shqiptarë çamë. Në qelitë e errëta të burgut të Janinës dergjeshin 34 shqiptarë nga Filati, me dhjetëra të tjerë nga kazatë e Margëlliçit dhe Paramithisë. Të njëjtat skena të dhunshme u përsëritën edhe në krahinat e tjera të Shqipërisë së Jugut: në Delvinë, Korçë, Kolonjë, Leskovik, Përmet, etj. Në vitin 1913, më shumë se 600 shqiptarë të Korçës dhe Kolonjës u burgosën në burgjet e Follorinës dhe të Selanikut.

Në Shqipërinë e Jugut, u dogjën nga bandat dhe forcat e armatosura greke më shumë se 300 fshatra shqiptare. Shumë gra, fëmijë dhe burra nga paria e Shqipërisë së Jugut u ekzekutuan barbarisht. Në atë kohë, as në Çamëri, as në Shqipërinë e Jugut, nuk ka patur shtyp dhe gazetarë të shpërndarë në terren, as përfaqësi diplomatike në shtetet europiane që të ngrinte zërin për gjithçka që ndodhte në Shqipëri.

Zëdhënësi i parë për ngjarjet e trazuara në Çamëri dhe në Shqipërinë e Jugut në vitet 1913-1914 u bë Mit'hat Frashëri. Ai kishte lidhje të ngushta miqësore dhe bashkëpunimi me një mik të madh të Shqipërisë, Aubrey Herbert. Në vitin 1913 u krijua Komiteti Shqiptar, ndërsa një vit më vonë Herbert u bë anëtar i këtij komiteti. Mit'hat Frashëri grumbulloi një informacion të gjerë dhe të saktë për krimet që kishin bërë grekët. Atë listë ia dorëzoi Herbertit i cili shkroi një artikull të gjatë në gazetën prestigjioze londineze, "The Times". Informacionet që u botuan në gazetë e tronditën shumë Athinën dhe qarqet diplomatike të saj. Ministri grek në Londër, Gennaius, u përpoq t'i përgënjështonte, duke i quajtur sajesa të Herbertit dhe informacione të pasakta, por Herberti në shkrimet e tij ishte shumë argumentues, i saktë dhe konkret dhe në artikujt që pasuan ai tregonte me

emër dhe mbiemër çdo të vrarë nga paria e Çamërisë. Madje, më 15 prill të vitit 1914, në gazetën "The Times", ai shkroi për djegien e 14 shtëpive në Delvinë, shtëpitë e muslimanëve në Ogrenë, si edhe shtëpinë e priftit Melan. Greqia nuk i respektonte traktatet dhe konventat që kishte nënshkruar lidhur me minoritetet çame. Në vitin 1913 ishte nënshkruar një traktat me qeverinë turke, sipas të cilit Athina do të respektonte liritë dhe të drejtat qytetare të minoriteteve në territoret e pushtuara prej saj, njëlloj si shtetasit e vet. Në nenin gjashtë thuhej se atyre të traktatit do t'u garantohej e drejta e pronësisë së pronarit mbi pronën e vet... Ky angazhim i qeverisë greke, jo vetëm që nuk u respektua, por u ndërmorën masat e egra për shpronësimin e shqiptarëve që në vitin 1913, për spastrimin etnik të tyre, për mungesën e lirive dhe të drejtave qytetare: nuk lejohej arsimi në gjuhën amtare, institucioni i kultit dhe xhamitë në fshatrat dhe qytetet e Çamërisë u kthyen në salla kuajsh. Në këtë situatë tejet të rënduar spikatën disa figura të shquara të diplomacisë shqiptare dhe disa zëra të fortë të rretheve patriotike të Çamërisë që morën në duar një mision të lartë diplomatik, për të ngritur zërin e protestës kudo që mundnin, pranë qeverisë greke, Lidhjes së Kombeve, qeverisë së Tiranës etj. Në fillim të vitit 1923, Shqipëria lidhi marrëdhënie



diplomatike me Greqinë, ndërsa përfaqësuesi i parë diplomatik i Tiranës u caktua Mit'hat Frashëri, një derë e madhe patriotike, një intelektual me një kulturë shumë të gjerë dhe një patriot i vendosur, i përgjegjshëm, që nuk vinte asgjë mbi çështjen kombëtare. Që në fillim ai grumbulloi një informacion të gjerë mbi situatën e vështirë që përjetonte komuniteti çam dhe në shenjë proteste, herë pas here, përcillte notat e ankesës dhe të shkeljes së të drejtave të minoritetit shqiptar në Greqi. Heshtja e qeverisë greke e detyroi diplomatin shqiptar që në fund të nëntorit 1923 të takonte zotin Veronik, Drejtorin e Përgjithëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Greqisë. Para tij ai protestoi për të ngarkuarin e Mbretërisë Shqiptare, i cili që nga marsi deri në nëntor të vitit 1923, kishte dërguar në Drejtorinë e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Greqisë 120 nota, pa marrë asnjë përgjigje. Zyrtari i lartë grek, për të lehtësuar qeverinë greke dhe sektorin që drejtonte vetë, i propozoi Mit'hatit që të bënte një ankesë të re që do ta studjonte me preferencë.

Cilat ishin ankesat e përfaqësuesit të qeverisë shqiptare që i drejtosheshin Ministrisë së Punëve të Jashtme të Greqisë?

Së pari, shpronësimet e padrejta që u bëheshin pronarëve shqiptarë, ishin në kundërshtim me të gjitha normat e të drejtës ndërkombëtare. Këto prona i merinin grekët dhe pronarët u kthyen në bujq të tyre. Së dyti, refugjatët grek të ardhur nga Azia e Vogël, të përkratur nga administrata lokale, kishin zënë të gjitha pronat e shqiptarëve në fshatrat e Çamërisë, përfshirë edhe kullotat dhe ishin vendosur padrejtësisht në shtëpitë e tyre,

ndërsa familjarët çamë ishin vendosur në kasolle lopësh, etj. Së treti, qeveria greke kishte ndërmarrë një fushatë të egër spastrimi për t'i larguar çamët nga trojet e tyre në viset e Anadollit, duke i konsideruar turq. Së katërti, për t'ia bërë jetën e vështirë dhe të padurueshme banorëve myslimanë të Çamërisë, bandat greke qarkullonin nëpër fshatra duke mbjellë frikë e terror dhe duke vrarë apo burgosur njerëz të pafajshëm, nën akuza të sistura me pretendimin se në familjet çame strehoheshin banda kriminale që kishin për qëllim rrëzimin e qeverisë greke.

Në prill të vitit 1923, Mehmet Konica u emërua Ministër Fuqplotë i Shqipërisë në Londër. Ai ishte një politikan dhe diplomat me emër, kishte një rreth të gjerë miqsh dhe mbështetës së Shqipërisë në Londër. Ai i përqendroi të gjitha energjitë e tij në mbrojtje të çështjes shqiptare në përgjithësi dhe asaj çame në veçanti. Në nëntor të vitit 1923, nisi menjëherë kontaktet me zyrtarët më të lartë të diplomacisë angleze. Fillimisht, kishte shkuar në Foreign Office, ku verbalisht kishte paraqitur gjendjen e shqiptarëve në Çamëri dhe kishte kërkuar ndërhyrjen e qeverisë britanike pranë qeverisë greke që të respektoheshin angazhimet e marra në Traktatin e Lozanës (1923) (qeveria greke ishte zotuar se popullsia myslimane çame nuk do të përfshihej në shkëmbim). Përgjigja që mori diplomati shqiptar ishte: "Shqipëria si shtet i pavarur duhet t'i rregullojë vetë punët e veta dhe opinionin britanik nuk e dëshiron ndërhyrjen e qeverisë së tij në punët e jashtme, që janë jashtë interesave britanike". Në këtë kohë, situata

politike në Britaninë e Madhe nuk ishte e qetë. Aty kishte ndodhur shpërndarja e papritur e parlamentit dhe së shpejti priteshin zgjedhje të reja.

Mehmet Konica ishte njohës i mirë i politikës britanike. Ai e dinte se Anglia nuk e kishte patur kurrë për zakon të mbyllte sytë para thirrjeve për mëshirë, veçanërisht kur kjo thirrje vinte nga një popull që kishte besim dhe shpresonte të kërkesa e drejtëpërdrejtë që i bëhej Britanisë së Madhe. Mehmet Konica nuk mund të kuptonte cilat ishin arësyet që rasti i minoritetit shqiptar në Çamëri nuk po ngjallte asnjë dhimbje dhe asnjë emocion në Angli! Anglia në politikën e jashtme kishte dy shkolla: E para kishte ekzistuar që në kohën e Bajronit, që besonte tek Galibardi. Kjo shkollë bënte përpjekje të mëdha për të ndihmuar popujt e pafuqishëm dhe kombësitë e vogla. Shkolla e dytë ishte një shkollë e veçantë, që nuk ndërhynte dhe qëndronte indiferente nëse ishte jashtë interesave të veta materiale. Situata në Çamëri arriti kulmin e tensionimit në vitin 1923. Kjo erdhi si rrjedhojë e presioneve të qeverisë greke dhe masave të egra shtrënguese, duke i detyruar çamët që të deklaronin pa zhurmë dhe bujë, me gojën e tyre, se kërkonin të shpërnguleshin. Kjo mënyrë mizore që përdori qeveria greke për të grabitur pasuritë e shqiptarëve kishte krijuar një shqetësim serioz tek elita e diplomacisë shqiptare, e cila nuk hoqi dorë nga detyra atdhetare, duke u përpjekur vazhdimisht në kërkim të një zgjidhjeje.

Vijon në numrin e ardhshëm....

MUSA DEMI



Musa Demi, ishte një revolucionar shqiptar dhe shkrimtar. Ai ka lindur në vitin 1878, në Filat, në atë kohë qytezë e Perandorisë Osmane. I ati i tij, Hamit Demi, kishte qenë pronar toke nga familja Demi e Filatit.

Musa Demi, mësimet e para i mori në Filat, ndërsa shkollën e mesme e kreu në Janinë. Ai u bë një ndër veprimtarët më të shquar të Lëvizjes Kombëtare. Në formimin e tij, krahas prindërve, një rol thelbësor ka luajtur edhe vëllai i tij i madh, Rexhep Demi, i cili zhvillonte veprimtari të dendur politike. Më 1895-ën, Musa Demi dhe vëllai i tij, kishin krijuar lidhje bashkëpunimi me shumë patriotë çamë. Nëpërmjet atdhetarëve shqiptarë të cilët vepronin jashtë atdheut, ata siguronin libra dhe gazeta shqip, të cilat i merrnin dhe i shpërndanin, jo vetëm në

Çamëri, por edhe më tej. Megjithëse veprimet e tyre ishin të kujdesshme, autoritetet turke ranë në gjurmë të tyre dhe në vitin 1895 Musa Demi u arrestua dhe u dënua nga gjykata e Janinës, me një vit e gjysmë burg. Por edhe pse kjo veprimtari atdhetare i kushtoi lirinë, Musa Demi, pas kthimit nga burgu, e vijoi edhe më me devotshmëri misionin e tij. Pas viteve 1905, Musa Demi njihej si figura e një atdhetari të shquar jo vetëm në Çamëri, por edhe në të gjitha rrethet patriotike të Shqipërisë së sotme. Nëpërmjet lidhjeve që kishte krijuar me bashkëpunëtorët e tij, ai ishte i mirinformuar për gjithçka që ndodhte në Çamëri dhe këtë informacion e shfrytëzonte për shtypin patriotik, si armë të fuqishme në shërbimin për çështjen kombëtare. Më 25 gusht të vitit 1908, Musa Demi, bashkë me rilindas të tjerë, hapi në Filat shkollën e parë në gjuhën shqipe. Ishte pikërisht Mehmet Sejko që vuri në dispozicion shtëpinë e tij për arsimimin e brezave të ardhshëm. Këtë lajm të gëzueshëm, Musa Demi, me anë të një telegrami, e botoi në gazetën “Liria”: “Me gaz të madh, u apim sihariqin se sot çelëm me shumë

lavdi një shkollë shqipe dhe bëmë disa fjalë mëmëdhetar-isht...” Mësuesi i parë i kësaj skolle ishte pikërisht Musa Demi, i cili sëbashku me Rasih Dinon, siguroi edhe fondet për ndërtimin e shkollës.

Musa Demi ka qenë një nga organizuesit kryesorë të klubit “Vëllazëria” të Filatit, të themeluar në vitin 1908. Klubi u angazhua qysh në fillim me Lëvizjen Kombëtare. Përveç 30 patriotëve nismëtarë, në klub merrnin pjesë edhe njerëz të thjeshtë të qytetit dhe fshatrave përreth. Klubi u kthye menjëherë në një vatër kombëtare ku rriheshin problemet e mprehta të kombit dhe të Çamërisë në veçanti.

Shkrimi i parë i Musa Demit u botua në gazetën “Liria”, që dille në Selanik. Veprimtaria e tij atdhetare vijoi më tej me rolin e tij thelbësor në hapjen e gazetës “Zgjimi i Shqipërisë”. Kjo gazetë shënonte një sukses të madh jo vetëm në klubin shqiptar të Janinës, por edhe në shtypin shqiptar në përgjithësi. Me shkrimet e tij në faqet e kësaj gazete, Musa Demi mbrojti me vendosmëri kërkesat dhe të drejtat e shqiptarëve, si edhe demaskoi hapur veprimet arbitrare të

xhonturqve dhe qarqeve shoviniste greke.

Gjatë viteve 1908-1913, falë aftësive si politikan dhe diplomat i lindur, gjakftohtë, i matur dhe i aftë për të dalë nga çdo vështirësi, ai arriti të hynte në marrëveshje të vazhdueshme me diplomatët e huaj në Janinë.

Në kryengritjen e viteve 1910-1912, ai u gjend shpesh në çetën e Muharrem Rushitit, me detyrën e këshilltarit politik dhe me cilësinë e përfaqësuesit të shoqërisë “Vëllezëria” të Filatit. Sipas përfaqësuesit të qeverisë austro-hungareze në Janinë, Bilinskit, Musa Demi ishte vënë përballë goditjeve të drejt-përdrejta të “Turqve të Rinj”, të cilët, në atë periudhë kishin në dorë pushtetin. Këta të fundit kishin filluar të shqetësoheshin në lidhje me këtë sepse veprimtaria e Musa Demit kishte ndikuar në qëndrimin që shqiptarët e Filatit kishin marrë kundrejt alfabetit me gërma arabe për shkrimin e gjuhës shqipe. Shqiptarët e Filatit e quanin udhëheqësin më të rëndësishëm të Lëvizjes Kombëtare. Për këtë arsye, “Turqit e Rinj”, jo në pak raste janë shprehur se ndaj Musa Demit duheshin marrë masa të rrepta.

Musa Demi ka qenë bashkëpu-

nëtor i Ismail Qemalit gjatë Luftës Ballkanike, si edhe drejtor i doganave të shtetit shqiptar. Gjatë pjesëmarrjes në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare



u zgjodh kryetar i këshillit.

Periudha midis viteve 1913-1922 karakterizohej nga rritja e presionit të qeverisë greke ndaj popullsisë. Në çdo zonë të Çamërisë vepronin banda të armatosura greke që terrorizonin popullsinë myslimane. Shqetësimet e Musa Demit për krimet dhe masakrat greke, u shprehën hapur në ankesat dhe protestat e njëpasnjëshme drejtuar qeverisë greke dhe konsujve të huaj që e kishin selinë e tyre në Janinë, Prevezë dhe Korfuz. Në këtë periudhë, Musa Demi, gjatë vizitave në konsullatat e huaja, bëri të njohur skenat e masakrave të dhunshme kundrejt popullsisë çame. Në

rrethanat e një terrori të egër, Musa Demi dhe patriotët e tjerë filluan të shkonin në Manastir, Vlorë, Durrës dhe Shkodër për të sensibilizuar përfaqësuesit e Fuqive të Mëdha dhe për të ngritur opinionin kombëtar për dramën çame. Këto ishin vetëm disa nga përpjekjet e patriotëve çamë si Musa Demi, në mbrojtje të interesave kombëtare. Përpjekjet e tij për të zgjidhur çështjen çame kanë vijuar pa ndalur deri në vitet 1944-1945. Në gjithë kalvarin e këtyre viteve, Musa Demi ka bërë të pamundurën që të arrinte në një marrëveshje me qeverinë greke, por gjithçka rezultoi pa dobi.

Në 1945-ën, vendimi i Presidiumit të Kuvendit Popullor e shpalli atë “Patriot të Rilindjes Kombëtare”. Musa Demi vdiq në vitin 1971, ndërsa më 1978-ën, me rastin e 100-vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, Presidiumi e nderoi atë me medaljen “Për Veprimtari dhe Aktivitete Patriotike”.

BEQIR META: “PËR ÇËSHTJEN ÇAME DUHEN KËRKUAR ZGJIDHJE QË I PËRSHTATEN KOHËS”



Më flisni për veten dhe për eksperiencat tuaja profesionale!

Studimet e larta i kam kryer në Universitetin e Tiranës, fakulteti Histori-Filologji, dega histori. Më tej, jam emëruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave të Shtetit në sektorin e botimeve të dokumenteve historike, ku kam mbajtur postin e kryetarit të Degës së Përpunimit Shkencor të Dokumenteve. Kam ushtruar detyrën si Përgjegjës i Sektorit të Botimit të Dokumenteve Historike në Institutin e Historisë. Më pas, kam vijuar punën kërkimore-shkencore si Studiues në Departamentin e Historisë së periudhës moderne të shtetit shqiptar. Aktualisht jam në pozicionin e drejtorit të Institutit të Historisë, si edhe nëndrejtor i Qendrës së Studimeve Albanologjike. Duke u bërë pjesë e Akademisë së Shkencave më është dhënë titulli “Akademik”.

Jam marrë me studimin e historisë së Shqipërisë për rreth 35 vjet. Kam shkruar dy vëllime në dy gjuhë, shqip dhe anglisht, “Tragjedia Çame”, si edhe bot-

imin “Minoritetet dhe ndërtimi kombëtar në Shqipëri - 1912-1924”. Këto dhe botimet e tjera që lidhen me marrëdhëniet shqiptaro-greke janë nxjerrë në dritë pas rreth 10-12

vitesh studime. Për të botuar studimet e mia jam bazuar në bibliotekat dhe arkivat nëpër botë si ato të SHBA-së, në Arkivin e Kombeve të Bashkuara, Neë York, Oxford, por edhe në arkivat e Ministrisë së Jashtme në Itali, Francë, Gjermani etj. Hulumtimi nëpër këto arkiva ka qenë shumë i vështirë, por frytdhënës për shkak se informacionet dhe dokumentet për Shqipërinë ishin të shumta.

Cili është identiteti shqiptar dhe si përfaqësohet ai në botën e jashtme?

Identiteti ynë ka pësuar evolucion duke kaluar nga faza e një popullsie në atë të një kombi (shek. XIX) në një gjuhë të vetme. Një gjuhë që fatmirësisht ka mbijetuar, por që ka patur fatin e keq të mungesës së gjuhës së shkruar. Megjithatë, është krijuar një komb me ndërgjegje, kulturë dhe histori identifikuese. Bota e jashtme na cilëson si një komb të bazuar në tre besime fetare, jo monoteiste (besimi në një fe), duke vlerësuar në këtë mënyrë kultivimin e tolerancës. Ndër karakteristikat e tjera që

vlerësohen te shqiptarët është gjithashtu

mbrojtja që këta të fundit u kanë dhënë hebrenjve, por edhe cilësi të tilla si besa, mikëpritja etj. Në perceptimin e vendeve të huaja, një ndikim jo të vogël kanë patur edhe mangësitë e kombit tonë, si egoizmi i theksuar i elitave politike, zhvillimi i dobët politik, ekonomik etj.

Në formimin tuaj profesional keni një botim shkencor “The Cham Tragedy”. Cili ka qenë qëllimi i botimit në anglisht dhe cilat kanë qenë reagimet që keni marrë pas botimit të tij?

Qëllimi i përkthimit në anglisht të “The Cham Tragedy” ka qenë ndërkombëtarizimi, pra njohja e kësaj çështjeje, e cila për shumë kohë ka qenë e mbuluar për shkak të presioneve asimiluese të shtetit grek, që fatkeqësisht u finalizuan gjatë Luftës së Dytë Botërore, duke përfutur nga kjo periudhë delikate. Synimi im me këtë libër është tërheqja e vëmendjes së opinionit publik. Kjo është arsyeja që “The Cham Tragedy” është dërguar në Parlamentin Europian, Strasburg etj. Duhet theksuar se puna e studiuesit përfundon në realizimin e një botimi cilësor, por organizimi dhe shpërndarja e tij është detyrë e shtetit, organizatave të ndryshme, institucioneve etj. Kjo është një nismë që këto institu-

cione duhet ta marrin shumë seriozisht duke marrë parasysh që vetëm në 3 vite botimi ky libër ka patur impakt të madh në disa vende të huaja, përfshi edhe Greqinë.

Duke qenë historian keni studiuar dhe hulumtuar në detaje historinë e Shqipërisë. Cilat janë konkluzi

onet tuaja lidhur me marrëdhëniet që shteti shqiptar ka patur me Greqinë.

Konflikti çam ka qenë vetëm një pjesë e shkaktit të marrëdhënieve të tensionuara. Edhe pse në kuptimin e parë nuk ka patur luftë ndërmjet dy shteteve, ka patur periudha të vështira, me histori të mbushura me tensione. Dy kanë qenë arsyt kryesore që kanë dominuar këto marrëdhënie të tensionuara. Çështja çame, që arriti kulmin me spastrimin e plotë dhe çështja e Shqipërisë së Jugut apo e Vorio-Epirit e quajtur ndryshe nga shteti grek. Në vitin 1914, në Epirin e Veriut, Greqia realizoi një gjenocid të njëjtë me atë të Çamërisë, por brenda territorit të shtetit shqiptar. Ndërsa në Çamëri, akti i parë, ka qenë ai i shkëmbimit të popullsisë dhe më tej, nëpërmjet nënshtrimeve, presioneve dhe spastrimit, u arrit në procesin final të gjenocidit, ku u godit në zemër Çamëria.

Pse Greqia ka patur si synim të vazhdueshëm trojet shqiptare?

Me justifikimin e shtrirjes së besimit ortodoks, Greqisë iu krijua mundësia për të zgjeruar kufijtë. Sigurisht që nuk duhen lënë jashtë vëmendjes edhe shkaqet ekonomike duke marrë parasysh pasuritë e lakmueshme të Çamërisë.

Sipas jush, përse Gadishulli Ballkanik ka qenë gjithmonë kaq i trazuar, mendon se ka ndikim nacionalizmi? A është ky një përbërës i mburjuar thellë në karakterin e popujve ballkanikë?

Nacionalizmi është element i pranishëm në çdo komb. Në thelb, ideologjia kombëtare është nacionalizëm. Problemi i vërtetë nuk është ky i fundit, por shovinizmi që është karakteristikë e disa kombeve. Kur nacionalizmi vihet në mbrojtje të kombit, ky përbën një faktor pozitiv, por nëse ai është agresiv atëherë përbën shovinizëm, i cili ndikon negativisht. Nacionalizmi ballkanik mbështetet te feja ortodokse, ndryshe nga nacionalizmi shqiptar që bazohet te kultura e kombit. Një tjetër aspekt pozitiv është edhe fakti se Shqipëria nuk e ka patur kurrë karakteristikën e ekspansionit.

Çfarë solli tranzicioni në Shqipëri dhe në botëkuptimin historik, veçanërisht lidhur me zhvillimet çame?

Ka patur ndikim pozitiv në rihapjen e çështjes. Kjo ka qenë arritje e rëndësishme pasi shqiptarët tashmë e kanë të qartë çështjen çame dhe njohën plagën e saj. U krijuan shumë institucione në mbrojtje të kësaj çështjeje si Shoqata Çamëria, Instituti i Studimeve për Çamërinë etj., që kanë luajtur rol pozitiv në prezantimin dhe trajtimin e problemit. Megjithatë, problemi është ngritur në mënyrë më të kujdesshme për shkak të pozitës së shteteve në fjalë. Greqia është një shtet i konsoliduar, ndryshe nga Shqipëria që është më i dobët. Një tjetër karakteristikë që vlen për t'u përmendur është pozita e vendeve në vëmendjen ndërkombëtare. Në aspektin politik, por edhe ekonomik, Shqipëria, ndryshe nga Greqia, shihet më pak e fuqishme, nisur edhe nga faktori i ndikimit të periudhes së diktaturës.

Cilat do të ishin strategjitë më produktive lidhur me integrimin dhe stabilitetin ndërmjet shteteve ballkanike, pa lënë jashtë vëmendjes zgjidhjen e çështjes çame?

Rindërtimi i Europës duhet bërë nëpërmjet bashkimit të vlerave. Duhet vënë në dukje si vlerat ashtu edhe problematikat. Në rastin e çështjes çame ajo është çështje politike, juridike dhe ekonomike që kërkon zgjidhje. Kompromisi ka për synim:

njohjen e fajit dhe kthimin e pronave. Vetëm kështu nis rruga e zgjidhjes. Hapi i parë në strategjitë për zgjidhje është kufizimi i ndjenjës shoviniste. Edhe në Kosovë pati një imitim të shovinizmit dhe spastrimit që iu bë çamëve, por përparësia e Kosovës, përveç numrit më të lartë të popullsisë, ishte edhe opinionioni dhe ndërhyrja e ndërkombëtarëve, të cilët nuk mund të lejonin një spastrim të tillë në mes të Europës. Çështja çame ka nevojë për studim të thellë në mënyrë që të kërkohet zgjidhje që i përshtatet kohës. Rruga më e mirë për t'u shndërruar në vende alate është nëpërmjet hapave të ngadalta, por të sigurt.

Nëpër botimet historike, kryesisht në tekstet shkollore, tragjedia çame duket shumë e vagëllt. Cilat janë motivet që kjo tragjedi pasqyrohet vetëm në pak reshta. Nuk është bërë e mundur të mblidhet informacioni i duhur dhe i zgjeruar apo sistemit politik nuk i intereson të thuhet të gjitha detajet?

Në botimet mbi historinë e Shqipërisë ka shumë dobësi. Në botimet e 2007-ës, çështja çame trajtohet mirë në dimension real. Për sa u përket teksteve mësimore, ka përmirësim, është trajtuar historia e Çamërisë, edhe pse jo shumë gjerësisht. Megjithatë, mesazhet jepen qartë. Ka përmirësime në

botime, por ne dëshirojmë t'i thellojmë më tej këto studime për ta bërë më të plotë. Që të realizohet kjo, ka nevojë për financime nga shteti, për më shumë studiues etj. Duhet thënë se politika nuk ka patur shumë interes për studimet albanologjike në përgjithësi.

Sipas jush pse u konceptuan kaq të cingurara kufijtë e Shqipërisë?

Shkaku kryesor është mosbalanca e forcave të shteteve ballkanike kundrejt një kombi të vogël, si Shqipëria, të përçarë, të paintegruar, të dobët në nivel institucional dhe ekonomik, ndryshe nga fqinjët e vet. Me fjalë të tjera, kjo është historia e një gare mes kombeve, ku të vonuarit humbasin.

Puna juaj e madhe në mbledhjen, hulumtimin dhe zbulimin e dokumenteve të reja nga arkivat e shteteve të tjera, mendoni se ka ndikuar në ndryshimin e rrjedhës historike të çështjes çame, ka dhënë më shumë përgjigje apo çfarë ndikimi tjetër ka patur?

Është shumë të pretendohet se puna në arkiva dhe zbulimi i dokumenteve të reja ndikon në ndryshimin e rrjedhës historike, pasi kjo do të kishte sjellë zgjidhjen e çështjes. Të jem realist, nuk bëhet fjalë për ndonjë përm-

bysje historike, por duhet thënë se kjo punë studimore ka sjellë ndryshime të mëdha pozitive. Të gjitha këta fakte përbëjnë një ndryshim shumë të madh, madje gjigand në njohjen dhe mentalitetin shoqëror të çështjes çame, ndryshim ky jo vetëm utilitar, por që i shërben edhe formimit tonë kombëtar. Është pikërisht historia që formon ndërgjegjen e një kombi, si edhe institucionet e ndryshme. Pra, historiografia ka shërbyer në sjelljen e ndryshimeve të mëdha. Ne, si studiues, jemi të kënaqur që ajo punë kolosale ka dhënë frytet e veta. Kombi ynë është bërë më i plotë falë rëndësisë që studiuesit i kanë dhënë thellimit të studimit. Projekti ynë i fundit që është pjesë e një grupi historianësh, përfshin evidentimin e dokumenteve të ndryshme arkivore. Qëllimi ynë nuk është arritja e një përmbysjeje rrënjësore, por zgjerimi i fakteve. Jemi ende në pritje të rezultateve.

Ju keni mbajtur shumë kumtesa lidhur me problemin çam dhe duket që i keni ndjekur hap pas hapi. Cila ka qenë arsyeja që i keni dedikuar kaq kohë dhe mund kësaj çështjeje?

Unë nuk jam as i pari dhe as i vetmi studiues që është marrë me çështjen çame, por jam ndër të parët. Arsyeja është rëndësia që mbart kjo temë. Mangësia më e madhe në Shqipëri është që

përgjithësisht, me këtë pjesë të rëndësishme të historisë merren studiues çamë. Unë nuk jam çam, por mbi të gjitha jam historian, shqiptar dhe merrem me studimin e historisë së Shqipërisë. Çështja çame është një çështje fisnike, ndërsa për mua trajtimi i saj, është detyrim shpirtëror, njerëzor, por edhe shkencor. Kjo është arsyeja që unë angazhohem ta studioj në mënyrë objektive, sado e vështirë mund të jetë kjo e fundit.

Duke qenë kaq shumë në brendësi të kësaj çështjeje, realisht besoni se një ditë do të zgjidhet dhe do të marrë një përgjigje përfundimtare çështja çame apo koha nuk është në favor duke i bërë shpresat të veniten?

Fjalën tuaj “besoj” dëshiroj ta zëvendësoj me “shpresoj”. Kam shpresë se Evropa e ardhshme do ta shpjerë drejt një zgjidhjeje kompromise. Nuk mendoj se do të lihet në harresë. E ardhmja e marrëdhënieve shqiptaro-greke duhet të shkojë në mbyllje të plagëve, por kjo duhet realizuar nëpërmjet humanizmit.

Lufta nëpërmjet kumtesave, monografive dhe botimeve dokumentare mbi çështjen çame në veçanti, por edhe historike në përgjithësi, ndihmon në ndikimin e zgjidhjeve të këtyre problematikave?

Padyschim që ndihmon. Njohuria është fuqi, pushtet. Shkrimi i historisë nëpërmjet historianëve është nxjerrja e të vërtetës. Nëpërmjet përdorimit të duhur të këtyre informacioneve, institucionet përkatëse përmirësohen.

Pas viteve '90 janë bërë përpjekje të vazhdueshme për të patur marrëdhënie miqësore ndërmjet Shqipërisë dhe Greqisë, por në të vërtetë, gjendja ndërmjet tyre ka qenë gjithnjë e tensionuar. Përse ndodh kjo sipas jush?

Në historinë 100-vjeçare të ekzistencës së shtetit shqiptar, këto janë marrëdhëniet më pozitive që kemi patur ndonjëherë. Por me Greqinë na lidhin ende problematika delikate që kanë vështirësi zgjidhjeje. Duke filluar që nga çështja çame, përpjekja e Greqisë në përhapjen e helezmit, problematikat e emigrantëve etj. Të gjithë këtë marrëdhënie të tensionuar unë e kam analizuar më qartë në botimin tim “Tensioni greko-shqiptar”.

Mund të na tregoni diçka për planet tuaja profesionale në të ardhmen? Ndonjë botim që pritet të dalë? Po për çështjen çame?

Për momentin kam në dorë vëllimin e dytë të librit që përmban shumë fakte, “Minoritetet dhe ndërtimi kombëtar në Shqipëri”, ku është prekur

pjesërisht edhe problem çam. Një tjetër projekt është studimi i historisë së Shqipërisë gjatë shekullit XX, në një botim me dy volume, ku analizohen përkatësisht vitet 1912-1944 dhe 1945-1990, me rreth dy mijë faqe secila. Në këtë projekt është përfshirë një grup pune prej 36-37 studiuesish. Ky nuk do të jetë një botim që do të përfshihet në tekstet shkollë, megjithatë do t'u shërbejë atyre botimeve dhe ka për qëllim të sjellë risi dhe fakte të reja historike.

ÇAMËRIA DHE DIPLOMACIA SHQIPTARE

Instituti i Studimeve për Çamërinë më datë 26 prill, e çeli edhe për këtë vit sezonin e aktiviteteve, me konferencën shken-core me temë “Çamëria dhe diplomacia shqiptare”, ku për herë të parë u publikuan dokumente, informacione dhe pamje të papublikuara më parë rreth Çamërisë.

Edhe këtë herë, të ftuar në konferencë ishin profesorë, historianë edhe studiues të njohur.

Historiani Pëllumb Xhufi, gjatë referimit, analizoi çështjen çame dhe situatën në të cilën ndodhej Çamëria gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Profesori i mirënjohur Hajredin

Isufi, këtë herë, u përqendrua në një vështrim të përgjithshëm të çështjes çame dhe diplomacisë shqiptare në periudhën midis dy luftimeve.

Historiani Hamit Kaba realizoi një analizë të thellë studimore mbi çështjen çame në politikën e jashtme të Aleatëve të Mëdhenj gjatë viteve 1945-1946 dhe mbi qëndrimin e diplomacisë shqiptare në periudhën midis dy luftimeve.

Profesor Irakli Koçollari u përqendrua më shumë në një aspekt artistik të paraqitjes së qyteteve çame dhe mënyrës se si është prezantuar ajo në veprat e piktorëve të huaj. Ai ngjalli

interes të jashtëzakonshëm të të ftuarit nëpërmjet paraqitjes së skicave dhe tablove të rralla nga Çamëria, të realizuara nga udhëtarë dhe diplomatë të huaj. Këto pamje interesante, profesor Koçollari i kishte përgatitur për t'i paraqitur ekskluzivisht për herë të parë në këtë konferencë. Diana Mone, nën temën “Historia e Çamërisë në folklor”, na zgjoi nostalgji duke na kujtuar folklorin çam me këngët e bukura çame dhe veçoritë kuptimore dhe leksikore, duke na vërtetuar edhe njëherë pasuritë folklorike që mbart kultura çame.



ZANA E JONIT

Si vajza e valëve pret buzë Jonit
Të riçelin portokallet
Të kokërrmbushen ullinjtë e lashtë,
Të rrëfesh një këngë me fyell
Të përkundesh në një djep erërash.

Si zanë s'tu ndal ditëve, netëve
Je peshkatar që detin e ke në zemër
Në dorën e rrudhur.
Je vetë dielli
Që re arkivash, traktatesh, paçavure
historie
S'ta byllën syrin e bukur.

Kapedane e lodhur një çast nga vitet
Mes tufaneve të reja të jetës
Hapi i udhës sadopak t'u rëndua.
Në vitet pa bij, pa nënat çame,
Pa bëma detarësh.
T'u thelluan rrudhat e ballit
E një thinjë e re t'u shtua
Ti det i dhimbjes
Ti det i mallit
Det i pafund dashurie.

Klaj, moj nënë, klaj
Për fatin e zi që të dhanë
E mbyllja portën portës së harresës!
Rimbille gëzimin e çiltër në buzë
Thaj, moj thaj, lotët e mallit
E rizgjoje
Shpirtin e paepur të qëndresës!

Një kurorë të re dashurie
Për ty të ringrejme NESËR!

SYTË E ÇAMËRISË

Sytë e tu
Të mbushur me miliona
flamuj
Gëzimi
Shprese,
Të mbushura me miliona
plisa ugari.
Gatuar me lotin e kripur të
detit të mallit.

Ah, sytë e tu!
Det i pafund ku hedh
spirancen dhimbja
Një palë dhioli ku drithëron
një zë
Që sjell tufane dasmash
Tufane
Vajesh.

Ku gjëmon një opingë në
truall
E sjell fllad ullinjsh
Rrokullima orteku që
treden.
Amanet, o qiell,
Që hap dyert e dritës çdo
mëngjes.

Amanet, o natë,
Që tret dftet, mallet, udhët.
Mos ia mbyll sytë
Çamërisë!

Eh, sytë e Çamërisë sime
Të thellë sa nuk mund t'i
mat.
Kush ju pa aq afër
E mik me legjendat nuk u
bë në çast.

Nga NAMIK SELMANI

*Konferenca Shkencore:
Çamëria dhe Diplomacia Shqiptare
26/04/2014*



*Scientific Conference:
Chameria and the Albanian Diplomacy
26/04/2014*

